

01-03  
**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN** - Departamenti i Përgjithshëm gjyqtari i vetëm gjykues Artan Sejrani, me sekretarën juridike Florije Kolukaj, në lëndën penale kundër të akuzuarit B. G. nga Prizreni rr. " " llam. nr. , për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 161 parg.1 të KPK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr.3140/10 të dt.17.04.2012, për dhënien e urdhërit ndëshkimor, gjykata jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 28.02.2013, muar këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I akuzuari:**

B. G. , nga Prizreni rr. " " llam. nr. , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**Ë S H T Ë F A J T O R Ë**

Se me dt. 08.10.2010, rreth orës 9,30 minuta, në Gjykaten e Qarkut në Prizren, gjatë seancës së konfirmimit të aktakuzës, i pandehuri B. G. seriozisht e kanos të dëmtuarin Sh. M. , në atë mënyrë, derisa gjatë seancës së konfirmimit të aktakuzës në Gjykaten e Qarkut në Prizren i pandehuri e kanos seirozisht të dëmtuarin duke i thënë "tash do ta pë gjakun un ty, vetëm një budallë mundet me u perla për ujë, dhe nuk kam ndërmend kurri me u pajtua me ty, nuk e la kurrrë pa ta marrë hakun".

**Me këto veprime ka kryer veprën penale të kanosjes nga neni 161 parag. 1 të KPK-së.**

Andaj gjykata pas vlersimit të shkresave të lëndës, në kuptim të nenit 493 dhe 495 të KPP-së jep këtë:

**URDHËR NDËSHKIMOR**

**PRANOHET KËRKESA** e Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshem, për dhënien e urdhërit ndëshkimor, PP.nr.3140/2010 të dt.17.04.2012.

Andaj gjykata ne kuptim të nenit 4,41,43 par.1 nën par 1.3, nenit 46,73 dhe nenit 161 parag. 1 të KPK-së, të akuzuarit ia shqipton:

## DENIMIN ME GJOBË

Ashtu që gjykata të akuzuarit B...G... ia cakton dënimin me gjobë në lartësin prej 250 (dyqindepesëdhjetë) €, të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Në rastë se dënim me gjobë nuk realizohet as detyrimisht, konform nenit 46 të KP-së, gjykata dënimin me gjobë do ta zëvendësoje në dënim me burg, konform nenit 46 parag. 4 të KP-së.

I dëmtuari Sh. ... M... nga Prizreni rr. "..." nr. ..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civilë.

I akuzuari obligohet që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sa do që të jenë ato, sipas llogarise se bërë në arkën e kësaj gjykate si dhe paushallin gjyqësore në shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

### Arsyimet

Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti i përgjithshem, pranë kësaj gjykate, ka parashtuar aktakuzën PP.nr.3140/2010 të dt. 17.04.2012, kundër të akuzuarit B...G... nga Prizreni, për shkak të veprës penale të kanosjes nga neni 161 parg. 1 të KPK-së. Të cilës ia ka bashkangjitur kërkesën, me të cilën i ka propozuar gjykatës që të pranoi kërkesën për dhënen e urdhërit ndëshkimor dhe të merr aktgjykim pa e mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, me të cilin të akuzuarit do ti shqiptoj dënimin me gjobë, me arsyetim se ka prova të besueshme se i akuzuari e ka kryer vepren penale e cila i vihet në barrë. Dhe konform nenit 493 te KPP-së, kërkoi që gjykata pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor te jep **URDHËRIN NDËSHKIMOR** me te cilin të akuzuarit do ti shqiptohet dënimini me gjobë.

Pas shiqimit të shkresave të lëndës dhe provave që gjinden në shkresat e lëndës, gjyqtari ka ardhur në përfundim se janë plotësuar kushtet ligjore nga neni 493 parag.1 të KPP-së, dhe në kuptim të nenit 495 parag.1 të KPP-së, vendosi që ta pranojë kërkesën për dhënen e urdhërit ndëshkimor.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë, kallximi penal i datës 12.10.2010 dhe procesverbali mbi marrjen në pyetje të të dëmtuarit me nr. PP.3140/2010 të datës 19.01.2012, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, u vërtetua se i akuzuari e ka kryer vepren penale me të cilën ngarkohet, andaj gjykata ia shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.


Vendimi mbi udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike ne kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 të KPP-së.

Vendimi mbë shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor u muar në kuptim të nenit 450 dhe 451 parag.1 dhe 2 të KPP-së.

Me sa u tha me larte, ne kuptim te nenit 495 parag.2 lidhur me parag.1 të KPP-së, u vendos si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN,**

P.nr. 498/12, me datë 28.02.2013



Sekretarja juridike,  
Florije Kolukaj

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi, në afat prej 8 ditëve, nga dita e marjes së të njëjtë, në këtë gjykatë. Po që se i akuzuari nuk paraqet kundërshtim në afatin e paraparë ligjor, aktgjykimi merr formen e prerë.

Degj: 12.03.2013  
Aktu: 1. Te podelimit  
2. Te etaktuarit  
3. PPL  
Të dhëjet 3 prill 2013  
Florije Kolukaj